



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
DREJTORIA E INSPEKTIMIT

Nr. 1617/prot.

Tiranë, më 28.09.2026

URDHËR

Nr. 199, datë 28.09.2026

PËR

ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 1617 PROT., NR. 79 DATË 28.09.2026 "PËR
MIRATIMIN E INSPEKTIMIT "PEZULLIMI I ÇËSHITJEVE PËRMBARIMORE,
KONFORM NENIT 615/DH TË KPC, NGA ZYRA PËRMBARIMORE GJIROKASTËR,
SARANDË, FIER, DURRËS"

Në zbatim të nenit 8 të Ligjit nr. 8/2023 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror", Urdhrit nr. 53 Prot., nr. 06, datë 12.01.2026 "Për miratimin e Planit të Zhvillimit të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror" të Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbarimit, Urdhrit nr. 159/3 Prot., nr. 68, datë 20.06.2025 "Për miratimin e Metodologjisë së Inspektimit të Veprimtarisë së Përmbaruesve Gjyqësorë Shtetërorë", i ndryshuar, Vendimit nr. 77 Prot., nr. 03, datë 13.01.2026 "Për miratimin e Planit Vjetor të Inspektimeve për vitin 2026" të Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbarimit, Planit të Punës për inspektimet nr. 77/1 Prot., datë 23.01.2026, Vendimit nr. 1617 Prot., nr. 79, datë 28.09.2026 të Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbarimit,

URDHËROJ

1. Zbatimin e Vendimit nr. 1617 Prot., nr. 79, datë 28.09.2026 "Për miratimin e Inspektimit "Pezullimi i çështjeve përmbarimore, konform nenit 615/dh të KPC, nga Zyra Përmbarimore Gjirokastër, Sarandë, Fier, Durrës", nga Grup i Inspektimit i përbërë si vijon:
 - Znj. Pavlin Doda Inspektor/Drejtoria e Inspektimit
 - Znj. Rezarta Ilia Inspektor/Drejtoria e Inspektimit
2. Inspektimit do të ketë objekt sipas planit të punës nr. 77/1 Prot., datë 23.01.2026 dhe tekstit bashkëlidhur të Vendimit nr. 1617 Prot., nr. 79, datë 28.09.2026 të Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbarimit.



3. Urdhërohen përmbaruesit gjyqësorë dhe Kryetarët e Zyrave Përmbarimore Gjisokastër, Sarandër, Fier, Durrës të vërë në dispozicion të Grupit të Inspektimit dokumentacionin e kërkuar, konform objektit të inspektimit, planit të punës dhe Metodologjisë së Inspektimit.
4. Metodologjia e përdorur nga Grupi i Inspektimit, për kryerjen e inspektimit do të kryhet sipas tekstit bashkëlidhur të Vendimit nr. 1617 Prot., nr. 79, datë 28.09.2026 të Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbarimit.
5. Brenda 30 ditëve nga përfundimi i inspektimit, Grupi i Inspektimit harton projekt raportin e inspektimit. Pas miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm, Zyra Përmbarimore Tropojë njihet me projekt raportin dhe ka të drejtë të paraqesë objeksionet e saj me shkrim brenda 10 ditëve nga data e marrjes dijeni. Brenda 30 ditëve nga miratimi i projekt raportit, pas shqyrtimit të objeksioneve, Grupi i Inspektimit harton Raportin Përfundimtar të Inspektimit.
6. Për çdo shkelje të konstatuar, Grupi i Inspektimit do të propozoj rekomandime dhe fillimin e hetimit disiplinor për personat përgjegjës.
7. Inspektimi do të zhvillohet nga data 09.10.2026 deri më datë 16.10.2026.
8. Ngarkohet Grupi i Inspektimit në Drejtorinë e Inspektimit dhe Zyrat Përmbarimore Gjirokastër, Sarandë, Fier, Durrës për zbatimin e këtij urdhri.
9. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

ERGYS QIRICI

